



Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA)

Njoftim

Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) njofton që Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur më 09.10.2015, me vendim unanim vendosi që Prof. Blerim Rexha të zgjidhet Kryetar i KSHC-së.

Prof. Blerim Rexha është profesor i asocuar në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina". Prof. Rexha është emëruar anëtarë i Këshillit Shtetëror të Cilësisë në muajin Mars 2015.

Me rastin e zgjedhjes, Prof. Blerim Rexha falënderoj anëtarët e KSHC për besimin e dhënë si dhe u zotua që do të punoj me përkushtim për zhvillimin e mëtejshëm të AKA-së dhe ngritjes së cilësisë së arsimit të lartë në Kosovë dhe bashkëpunimit ndërkombëtarë.

Po ashtu në këtë mbledhje, me vendim unanim KSHC vendosi që Prof. Lul Raka të zgjidhet Zëvendës Kryetar i KSHC-së. Prof. Raka është profesor asistent në Fakultetin e Mjekësisë, në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" dhe është emëruar rishtazi anëtarë i Këshillit Shtetëror të Cilësisë.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë shprehu falënderimin për Kryetaren e mëparshme të KSHC-së, Prof. Ferdije Zhushi për kontributin e dhënë në themelimin dhe konsolidimin e Agjencisë së Kosovës për Akreditim.

Datë: 09.10.2015